



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:030973

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05654539

**C.nr.38/21**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS) me seli në Bulevardin “Bill Klinton” nr.3, ndërtesa e Elektro-Kosovës, kati II, nr.5 Prishtinë-Distrikti në Gjakovë të cilën e përfaqëson Taulant Gashi me autorizim në shkresat e lëndës, kundër të paditurit R.A. M. nga fshati L./M., me objekt kontesti për kompensim të dëmit material, vlera e kontestit 257.62 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të datës 29.04.2024 të mbajtur në prezencë të paditëses dhe në mungesë të të paditurit, me datë 03.05.2024 mori dhe përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS) me seli në Bulevardin “Bill Klinton” nr.3, ndërtesa e Elektro-Kosovës, kati II, nr.5 Prishtinë-Distrikti në Gjakovë dhe **DETYROHET** i padituri R.A. M. nga fshati L./M., që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material t’ia paguaj shumën prej 257.62 € (dyqind e pesëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e dy cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë (04.02.2021) e deri në pagesën definitive.
- II. **Detyrohet** i padituri R. M., që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej njëzet euro (20.00 €), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit.

**A r s y e t i m**

Paditësja me datën 04.02.2021, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit R.A. M. nga fshati L./M., për shkak të kompensimit të dëmit material në vlerë prej 257.62 €. Në padi dhe nëpërmes të autorizuarit të saj gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridiko-civile dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se i padituri është përgjegjës për dëmin e shkaktuar në lartësi prej 257.62 euro, kjo pasi që nga aktgjykimi penal me numër P.nr.27/17 i datës 21.02.2019 i po kësaj gjykate dhe i formës së prerë nga data 02.07.2019 si dhe aktgjykimit me nr.350/18 i datës 11.11.2019 i plotfuqishëm me datë 11.12.2020, i padituri është shpallur fajtor për të gjitha pikat e aktakuzës duke përfshirë edhe dëmin e shkaktuar nga kjo vepër penale, ndërsa lartësia e dëmit është vërtetuar në bazë të dy faturave nr.... të datës 24.05.2016 dhe nr.... të datës 26.06.2018, ku

shihet se llogaritja e dëmit është bërë në bazë pajisjeve që i ka pasur i padituri në momentin e konstatimit të keqpërdorimit të energjisë elektrike, dhe kjo është bërë në pajtueshmëri me rregulloren për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, ku të paditurit, rikthimi i humbjeve i është llogaritur për tre muaj pasi që i njëjti ka pasur edhe më herët rikthim të humbjeve për faturën nr.... dhe i është llogaritur në mënyrë retroaktive për 6 muaj, ndërsa për faturën nr.... i është llogaritur në mënyrë retroaktive për 4 muaj.

Ka shtuar se llogaritja e dëmit në mjete monetare është bërë në bazë të dy faturave nr. D. e datës 24.05.2016 dhe nr. D. e datës 26.06.2018, andaj i ka propozuar gjykatës që të bëhet shikimi i provave dhe pas kësaj, padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe ta obligoj të paditurin me shpenzimet e taksës gjyqësore për padi në shumën prej 20.00 euro.

Edhe pse i padituri e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, ai nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa po ashtu nuk ka marrë pjesë në asnjërin prej seancave edhe pse ka prova se është ftuar në mënyrë të rregullt. I padituri nuk ka marrë pjesë në seancën e datës 26.07.2021, pastaj 28.03.2024 dhe 29.04.2024, ku për dy seancat e fundit, sipas fletë kthesave, i padituri ka refuzuar ta pranoj thirrjen.

Lidhur me mungesën e të paditurit, gjykata në kuptim të nenit 423.4 të LPK-së ku parashihet se: *"Po që se në seancën për shqyrtim kryesor nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes bëhet pa praninë e tij"*, kështu që shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të të paditurit i cili ishte ftuar në mënyrë të rregullt, por nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Siç u cek edhe më lart, i padituri nuk ka marrë pjesë as në seancën e fundit të datës 29.04.2024 dhe siç rezulton nga procesverbali i kësaj gjykate i datës 29.04.2024, gjykata ka konstatuar se në seancën e së njëjtës datë, prezent ka qenë e autorizuara e paditëses, kurse nuk ka prezantuar i padituri edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, por në fletë dërgesë konstatohet se ai e ka refuzuar atë.

Pas hapjes së seancës përgatitore, i autorizuari i paditëses ka propozuar dhe ka kërkuar nga gjykata që seanca të mbahet në mungesë të të paditurit, meqenëse i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt, por i njëjti ftesën e ka refuzuar, dhe lidhur me këtë, është marrë aktvendim që të kalohet në shqyrtim kryesor dhe të caktohet nxjerrja e provave.

#### Gjendja faktike e vërtetuar:

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor publik, ka administruar këto prova: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega e Gjykatës në Malishevë-Divizioni Penal me nr. P.nr.27/17 i datës 21.02.2019, i plotfuqishëm me datë 02.07.2019, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega e Gjykatës në Malishevë-Divizioni Penal me nr. P.nr.350/18 i datës 11.11.2019, i plotfuqishëm me datë 11.12.2020, dy faturat e kalkulimit RH nr...e datës 24.05.2016 dhe nr... e datës 26.06.2018, dy faturat e kalkulimit dhe rikthimit të humbjeve nr. D. e datës 24.05.2016 dhe nr. D. e datës 26.06.2018 dhe

dy njoftimet e datës 02.12.2020 dhe 14.12.2020 nga Departamenti Ligjor-zyra ligjore e KEDS, dërguar konsumatorit R.M..

Gjykata pas vlerësimit të provave të palës paditëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë edhe u aprovua.

### Gjendja faktike e vërtetuar

Nga Aktgjykimet penale të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, me nr. P.nr.27/17 i datës 21.02.2019, i plotfuqishëm me datë 02.07.2019 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega e Gjykatës në Malishevë-Divizioni Penal me nr. P.nr.350/18 i datës 11.11.2019 i plotfuqishëm me datë 11.12.2020, vërtetohet se i padituri i lartpërmendur është shpallur fajtor për veprën penale “Vjedhja e shërbimeve komunale”, nga neni 320 i KPRK-së dhe gjykata në rastin konkret e ka gjykuar atë: me aktgjykimin P.nr.27/17 me dënim me burgim prej 3 muaj dhe dënim me gjobë në shumën prej 100.00 €, kurse me aktgjykimin P.nr.350/18 e ka dënuar me dënim burgim prej 4 muaj, por të gjitha këto dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, ndërsa të dëmtuarën (këtu paditësen) e ka udhëzuar që të drejtën e saj për kompensim të dëmit, të realizojë në kontest civil.

Nga dy faturat e kalkulimit RH nr.... e datës 24.05.2016 dhe nr.... e datës 26.06.2018 dhe dy faturat e kalkulimit dhe rikthimit të humbjeve nr. D... e datës 24.05.2016 dhe nr. D.e datës 26.06.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se llogaritja e dëmit është bërë në bazë pajisjeve që i ka pasur i padituri në momentin e konstatimit të keqpërdorimit të energjisë elektrike dhe se llogaritja është bërë në mjete monetare, kurse nga dy njoftimet e datës 02.12.2020 dhe 14.12.2020 nga Departamenti Ligjor-zyra ligjore e KEDS, dërguar konsumatorit R. M., vërtetohet se i padituri është ftuar për të arritur marrëveshje, në të kundërtën do të fillohet me procedurat e parapara sipas ligjit.

### Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Me neni 137 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës nr.16, me datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012), parashihet se: “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”, ndërsa me nenin 136 par. 1 të parashihet se: “Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë t’u kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Në anën tjetër me nenin 14 të Ligjit Nr.06/L-006 për Procedurën Kontestimore parashihet se: “Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”.

Gjykata nga administrimi i provave, vlerësimet dhe analizimet të tyre, pretendimet e paditësit se i padituri i ka shkaktuar dëm paditëses i ka gjetur të bazuara. Nisur nga fakti se i padituri me aktgjykimet penale P.nr.27/17 i datës 21.02.2019 dhe P.nr.350/18 i datës 11.11.2019, është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, rrjedh se për gjykatën është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses, pasi që në rastin konkret gjykata lidhet me aktgjykimin penal i cili është i formës së prerë ku është vërtetuar përgjegjësia penale e të paditurit, kjo bazuar në nenin 14 të LPK-së. Ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke marrë për bazë faturat e kalkulimit RH nr.... e datës 24.05.2016 dhe nr.... e datës 26.06.2018 si dhe dy faturat e kalkulimit dhe rikthimit të humbjeve nr. D. e datës 24.05.2016 dhe nr. D. e datës 26.06.2018, sipas të cilave është konstatuar se i padituri me shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të paautorizuar i ka shkaktuar dëm palës paditëse në shumën e përgjithshme prej 257.62 €. Ne anën tjetër, i padituri në asnjë mënyrë nuk ka argumentuar se dëmi i lartcekur i paditëses, është shkaktuar pa fajin e tij.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim se i padituri me veprimet e tij, paditëses i ka shkaktuar dëm në lartësi prej 257.62 euro, fakte këto që u vërtetuan nga provat e administruara si më lart. Andaj si rezultat i kësaj gjendje faktike të vërtetuar, e në zbatim të dispozitave ligjore nga neni 137 dhe 136 par.1 të LMD-së, gjykata vendosi si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën -II- të këtij aktgjykimi, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së dhe suksesit në kontest, ashtu që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale iu pranua shuma prej 20.00 €, në emër të taksës gjyqësore të paguar për padinë e parashtruar.

Duke u bazuar nga të gjitha këto që u thanë më lart dhe në kuptim të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.38/21, datë 03.05.2024**

**G j y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.